



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .12.2025

Lënda: Përgjigje

Drejtuar: Z. S.Z. në cilësinë e studiuesit të lirë

TIRANË

I nderuar z. Z.!

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), me tonën nr. 1891 prot., datë 15.10.2025, me anë të së cilës bazuar në nënin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, kërkon: 1- vënien në dispozicion të Raportit përfundimtar të hetimit administrativ mbi dosjen M.C.; 2- Aktin e ekspertimit grafik të kryer nga ana e policisë shkencore për rastin 3- Raportin dhe konkluzionet e ekspertëve të huaj (gjerman) dhe 4- Relacionin e plotë mbi gjetjet e grupit të punës ngritur në AIDSSH për hetimin administrativ, të cilat do të përdoren me qëllim plotësimin e studimit që keni bërë mbi dosjen e M.C. Ju informojmë se:

Së pari: Ligji nr. 45/2015, në nenet 36-38 përcakton qartë subjektet kërkuese që mund të kenë qasje në informacion, objektin, qëllimin dhe përdorimin e informacionit, dispozitat procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, të drejtat e kërkuesve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve si dhe kriteret e përdorimit të informacionit.

Procedura që ndiqet për trajtimin e kërkesave me objekt si më sipër parashikohet në “Udhëzuesin për aksesin dhe përdorimin e arkivit të Autoritetit, për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar nga Autoriteti me Vendimin nr. 743, datë 19.12.2024. Në Udhëzues parashikohet se edhe punonjësit e Sekretariatit Teknik të AIDSSH-së, kur kanë kërkesa për qëllime studimore do të ndjekin të njëjtat hapa si nga çdo kërkues për qëllime studimore.

Në Raportin përfundimtar të grupit të punës, pasqyrohen të gjitha kërkesat studimore (studiues e gazetarë) të paraqitura në Autoritet që nga viti 2018 e deri në muajin qershor 2025 (koha e protokollimit të Raportit) të legjitimuara prej këtij të fundit gjithsej 7 (shtatë) kërkesa lidhur me dosjen e M.C. me vendimarrje konkrete për secilën kërkesë duke respektuar të drejtat e palëve dhe duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale.

Nuk rezulton sa më sipër të jetë paraqitur kërkesë nga ana juaj si studiues i lirë për vënien në dispozicion të dosjes së sipërcituar për qëllime studimore.

Së dyti: Sa i takon vënies në dispozicion të Raportit përfundimtar të hetimit administrativ mbi dosjen M.C., ju informojmë se Raporti përfundimtar mbi rezultatet e hetimit administrativ për verifikimin, qartësimin dhe plotësimin e të dhënave të dokumentacionit (arkivor) mbi figurën historike të M.C. është miratuar me Vendimin nr. 401 datë 11.09.2025 të Autoritetit dhe ky i fundit është publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit në formatin e kërkuar nga ligji. Kopje të dy dokumenteve të sipërcituara i gjeni bashkëlidhur.

Së treti: Përsa i përket pikave të tjera 2-4 të kërkesës për informacion dhe vënie në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” Autoriteti miratoi fillimin e procedurës së hetimit administrative me vendimin nr. 449, datë 14.07.2023 dhe miratoi ngritjen e grupit të punës me urdhrin nr. 155, datë 31.08.2023, ndryshuar me urdhrin nr. 179 datë 15.08.2024 “Për kryerjen e kërkimit të mëtejshëm, me objekt verifikimin administrativ për qartësimin, verifikimin rrethanave dhe plotësimin e të dhënave dhe dokumentacionit arkivor mbi figurën historike M.C.”.

Ky vendim përcaktoi detyrat konkrete për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të gjithë materialeve arkivore që lidhen me M.C., si dhe organizimin e mbledhjeve periodike të grupit të punës për hartimin e raportit përfundimtar.

Qëllimi i këtij hetimi administrativ është informimi dhe analizimi i dokumentacionit për M. C. të gjendur në burimet arkivore të disponuara në fondet e ish-Sigurimit të Shtetit administruar nga AIDSSH.

Bazuar në kreun “X Rekomandime” të Raportit përfundimtar mbi rezultatet e hetimit administrativ për verifikimin, qartësimin e rrethanave dhe fakteve, dhe plotësimin e të dhënave të dokumentacionit (arkivor) mbi figurën historike të M.C. i miratuar me Vendimin nr. 401 datë 11.09.2025 të Autoritetit, në pikën 1 rekomandohet – ***Vënia në dispozicion të studiuesve në përputhje me ligjin nr. 45/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse.***

Sa më sipër, objekti i kërkesës ka të bëjë me dokumentacion i cili i nënshtrohet dhe rregullohet me dispozitat e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”. Pra informacioni me të cilin operon Autoriteti publik konsiderohet informacion arkivor, të cilin për nga natyra e veçantë që paraqet, legjislatori e ka gjykuar të arsyeshme ta rregullojë me ligj të posaçëm sa i takon të gjithë aspektet përfshirë rrethin e personave që mund të kenë qasje në dokumentacion, kriteret që duhet të përmbushen për të pasur qasje, të drejtat e kërkuesit dhe niveli i qasjes.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti